



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Syllabusi i lëndës Analiza mikroekonomike

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike:		Fakulteti i Biznesit	
Titulli i lëndës:		Analiza mikroekonomike	
Niveli:		Bachelor	
Status i lëndës:		Obligative	
Viti i studimeve:		III (semestri V)	
Numri i orëve në javë:		3+2	
Vlera në kredi – ECTS:		5	
Koha / lokacioni:		FB	
Mësimdhënësi i lëndës:			
Detajet kontaktuese:			
Përshkrimi i lëndës		Në këtë lëndë mësohet Teoria e sjelljes konsumatore dhe Teoria e prodhuesit. Fokusi do të jetë mbi analizën e preferencave dhe konceptin e dobisë si hyrje për shtjellimin e zgjedhjes konsumatore; teoria e kërkesës; inputet dhe funksioni i prodhimit; koncepti i kostos dhe minimizimi i kostos, analiza e strukturës së tregut dhe diskriminimit të çmimeve; sjellja strategjike e firmave dhe teoria e lojërave; marrja e vendimeve në kushtet e pasigurisë si dhe eksternalitetet e tregut dhe efikasiteti ekonomik.	
Qëllimet e lëndës:		Kjo lëndë ka për qëllim që studentët të zgjerojnë dhe thellojnë njohuritë nga lënda e mikroekonomisë si dhe të aftësohen për të menduarit kritik lidhur me hulumtimet. Do të parashtrohen çështje të ndryshme për diskutim, të cilat do të jenë të gërshetuara me shembuj numerik, grafikë dhe ekuacione, në mënyrë që studentët të kuptojnë më thellë analizën statike krahasuese dhe të jenë më të përgatitur për interpretimin e ngjarjeve në tregjet reale.	
Rezultatet e pritura të nxënies:		Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të mund të demonstrojnë njohuritë e tyre në nivel të avancuar të : (i) teorisë së sjelljes konsumatore, (ii) teorisë së prodhuesit si dhe (iii) të dëshmojnë aftësinë e ofrimit të zgjidhjeve për problemet e ndryshme ekonomike.	
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej

Ligjerata, Kolokvium	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	2	2
Detyra shtëpie	1	5	5
Seminare, projekte, prezentimet,etj.	1	3	3
Koha e studimit vetanak të studentit	1	15	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	5	5
Përgaditja përfundimtare për provim	5	4	20
Totali			125
Metodologjia e mësimdhënies:	• Prezantimi i temës mësimore në Power Point • Përsëritja e temës paraprake nga grupi i caktuar i studentëve, analiza dhe diskutime • Rast studimi apo detyrë (për orën e ushtrimeve) lidhur me temën e ligjësuar		
Metodat e vlerësimit:	• Punimi seminarik dhe prezantimi: 0-20% • Kolokviumi i parë: 0-40% • Kolokviumi i dytë: 0-40% ose • Provimi përfundimtar 0- 80%		
Literatura			
Literatura bazë:	1. Hal R. Varian, “Mikroekonomia e aplikuar”, përkthim i botimit të tretë, 2010		
Literatura shtesë:	1. Thomas J. Nechyba “MICROECONOMICS- An intuitive approach”, 2011. 2. David Besanko, Ronald R. Braeutigam, “Microeconomics An Integrated Approach”, John Wiley & Sons, Inc., New York, 2002.		
Plani i dizejnuar i mësimi:			
Java	Ligjerata që do të zhvillohet		
Java e parë:	Prezentimi i syllabusit të lëndes		

Java e dytë:	Tregu
Java e tretë:	Kufizimi buxhetor
Java e katërt:	Preferencat e konsumatorit
Java e pestë:	Dobia dhe zgjedhja optimale
Java e gjashtë:	Kërkesa - mallrat normale dhe inferiore
Java e shtatë:	Zgjedhja intertemporale
Java e tetë:	Kollokviumi i parë
Java e nëntë:	Tregjet e aseteve
Java e dhjetë	Pasiguria – konsumi i kushtëzuar
Java e njëmbëdhjetë:	Teoria e lojes
Java e dymbëdhjetë :	Teknologjia
Java e trembëdhjetë:	Maksimizimi i profitit
Java e katërmëdhjetë:	Minimizimi i kostos
Java e pesëmbëdhjetë:	Kollokviumi i dytë

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Cakto politikat e mirësjelljes konform statusit të UHZ-së.

- Para së gjithash, studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat shkollore;
- Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në orën mësimore;
- Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e indeksit dhe mjetit të identifikimit në teste dhe provim;
- Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet të përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit;
- Testet dhe provimet vlerësohen individualisht për secilin student. Prandaj, studentet duhet të përqëndrohen vetëm në njohuritë personale.
- Shkelja eventuale e këtyre parimeve etike (rregullave) ndëshkohet konform normave të parapara me ligj.